



“Valorizimi i zejeve tradicionale dhe potencialet socio ekonomike në komunat Çair dhe Gjilan”

GRANTE PËR BIZNESE TË VOGLA DHE TË MESME THIRRJE PËR APLIKIM

Komuna e Gjilanit me mbështetje të Komisionit Europian bën shpërndarje të granteve të vogla me qëllim të mbështetjes së zejtarisë tradicionale dhe sipërmarrësve social në Komunën e Gjilanit.

1. Qëllimi i grantit: Qëllimi i ndarjes së sub-granteve është:
 - forcimi i dukshmërisë dhe
 - promovimi i zejeve tradicionale dhe sipërmarrësve social.
2. Kriteret për kualifikim:
 - Të ketë Certifikatë të Regjistrimit të Biznesit.
 - Dëshmi (deklaratë) që biznesi është në gjendje të bashkë financoj investimin.
 - Të jetë biznes aktiv në veprimtarinë e tij.
 - Të japin informata mbi produktet e tyre, të punësuarit dhe të përfaqësojnë sektore të ndryshme tregtare.
 - Kryefamiljarët, gratë dhe të rinjtë do të kenë përparësi.
3. Informata rreth granteve:
 - Shuma maksimale është 2,000 EUR.
 - Granti mbulon 60% te investimit ndërsa nga biznesi kërkohet pjesëmarrje në financim me 40% të shumës totale.
 - Nr minimal i grantete do të jetë 20.
 - Vëmendje të posaçme do ti kushtohet përfaqësimit të balancuar etnik dhe gjinor.
4. Investimi mund të bëhet në:
 1. Renovimi i dyqaneve të zejeve tradicionale dhe sipërmarrësve social
 2. Investimet për brendim dhe marketing të zejeve tradicionale dhe sipërmarrësve social
5. Sesionet informative dhe afatet:
 - Seancë informative: 24.11.2015
 - Afati i fundit për sqarime nga Autoriteti kontraktues: 14.12.2015
 - Dita e fundit për dorëzimin e aplikacionit: 15.12.2015
 - Njoftimin për shpërblim të grantit: 22.12.2015
 - Nënshkrimi i kontratës: 29.12.2015
6. Procedurat për aplikim:

Formulari për Aplikim mund të shkarkohet përmes web-faqes zyrtare të Komunës së Gjilanit <http://kk.rks-gov.net/gjilan> ose mund të merret në “Zyrën e Projektit të Bashkëpunimit ndërkuftar” në adresën: “Bulevardi i Pavarësisë”, ish Objekti i Ekzekutivit, Komuna e Gjilanit. Për informata më të hollësishme, ju lutem të na kontaktoni në numrin e telefonit: +377 44 631 797 ose email adresën: besmiree@gmail.com
7. Afati i dorëzimit të aplikacionit:

Formulari për aplikim dhe dokumentet e bashkangjitura duhet të dorëzohen në zyrën e Projektit deri me datë 15. 12 2015, çdo ditë pune nga ora 08:30-17:00.

